

VENDIM
Nr.6, datë 21.5.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani	Zv/kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Ylvi Myrtja	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Franc Jakova	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtare	e Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese

me sekretare Lumturi Cena në datat 15.12.1992, 14.4.1993 dhe 21.5.1993, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 6 Akti që i përket:

kërkuese: FIRMA FRANCEZE ADRIATIKU DFS SA, e përfaqësuar prej zotit Julien Roche dhe këshilltarit juridik të tij Piro Totozani.

PERSONI I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE i përfaqësuar nga Vasil Bendo.

OBJEKTI

Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 10.10.1992, me të cilin shpallet pavlefshmëria e autorizimit për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët ADA, i dhënë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.371, datë 20.10.1990.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relacionin,

VËREN:

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.371, datë 20.10.1990, është lejuar krijimi i ndërmarrjes së përbashkët "Adriatik" DFS Albania (ADA) për veprimtari ekonomike me pjesëmarrje të kapitalit të huaj në Republikën e Shqipërisë. Më datën 20.10.1990, Këshilli i Ministrave me vendimin e mësipërm ka lëshuar autorizimin për lidhjen e kontratës.

Kontrata është e lidhur më datën 01.11.1990 ndërmjet "Teknoimportit" (pala shqiptare) dhe Adriatik DFS SA (pala franceze).

Me vendimin Nr.435, datë 10.10.1992 Këshilli i Ministrave ka shpallur të pavlefshëm autorizimin për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët ADA dhe ka vendosur që për vazhdimin e veprimtarisë në Shqipëri të firmës Adriatik DFS SA të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e personave juridikë të huaj.

Në nenin 12 të Dekretit Nr.7407, datë 31.07.1990 "Për veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në RPS të Shqipërisë", është përcaktuar se autorizimi për lidhjen e kontratës për krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta jepet nga Këshilli i Ministrave. Nga provat e administruara rezulton se autorizimi është dhënë me vendimin Nr.371, datë 20.10.1990. Në këtë vështrim vendimi autorizues i Këshillit të Ministrave nuk është marrë në kundërshtim me kërkesat e Dekretit për krijimin e ndërmarrjeve me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj, përkundrazi akti individual i Qeverisë përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e Dekretit të

lartpërmendur. Ky Vendim i Këshillit të Ministrave për krijimin e personit juridik me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj dhe atij vendas është zbatuar, dmth, në bazë të tij është lidhur kontrata përkatëse.

Nga materialet e paraqitura dhe shpjegimet e dhëna nga të gjithë subjektet përkatëse rezulton se pala shqiptare, megjithëse, sipas pikës 10 të kontratës, detyrohej të derdhte pjesën përkatëse të kapitalit të caktuar, përfundimisht nuk e ka derdhur atë asnjë herë.

Që në fillim ADA, ka zhvilluar aktivitetin si shoqëri me kapital të huaj. Ndërkohë pala shqiptare që ekzistonte fillimisht si ndërmarrje shtetërore nuk ekziston më.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.435, datë 10.10.1992, që shpall pavlefshmërinë e autorizimit për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët, pavarësisht nga arsyetimi, nuk është i drejtë, sepse ai nuk bën tjetër veçse mohon të drejtat e fituara dhe një gjendje fakti që ekziston prej dy vjet e gjysëm.

Ligji që rregullon veprimtarinë tregtare të personave juridik të huaj i njeht kapitalit të huaj garancitë e duhura, por gjithashtu përcakton shprehimisht se do të zbatohet legjislacioni shqiptar në zhvillimin e aktivitetit të saj. Nga ana tjetër edhe vetë kontrata e statuti i shoqërisë ADA pranon shprehimisht zbatimin e legjislacionit shqiptar.

Sipas nenit 1 të Ligjit Nr.7632, datë 04.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", që është në fuqi, thuhet se në fushën e tregtisë zbatohet legjislacioni tregtar. Pas këtij ligji, ka hyrë në fuqi Ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare". Në këtë ligj parashikohen me hollësi edhe të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë tregtare si edhe sanksionet kur nuk respektohen ato. Ligji ka fuqi për të ardhmen, kur nuk parashikohet ndryshe në të. Sipas nenit 302 të ligjit të sipërm, njihet ekzistenca e shoqërive tregtare të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Por ligjvënësi ka ngarkuar Këshillin e Ministrave të përgatitë projektligjin për statusin e tyre. Nga ana tjetër, neni 64 i Ligjit Nr.7667, datë 28.1.1993 "Për regjistrimin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare", parashikon që shoqëritë tregtare të regjistruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rast se formalitetet e regjistrimit dhe kushtet materiale nuk i kanë në përputhje me këtë ligj, janë të detyruara të regjistrohen jo më vonë se 6 muaj nga hyrja e tij në fuqi (dmth, nga data 15.03.1993), duke respektuar kërkesat e tij.

Duke analizuar sa më sipër Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.435, datë 10.10.1992 është i papajtueshëm me Ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Në këto rrethana në mbështetje të rregullit që përshkon legjislacionin e shoqërive tregtare sipas të cilit shoqëria tregtare ekziston edhe kur mbetet një pjesëtar i saj, në parashikim edhe të miratimit të statusit që parashikon neni 302 i përmendur, kërkesa e partnerit francez të firmës ADA është e bazuar dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 24, pika 10/1 të ligjit "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

VENDOSI:

1. Pezullimin e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 10.10.1992 "Për shpalljen e pavlefshmërisë së autorizimit për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët "ADA" deri në rishqyrtimin e tij.

2. T'i njihet e drejta kërkuarit të vazhdojë veprimtarinë si shoqëri me kapital të huaj deri në miratimin e statusit të parashikuar nga neni 302 i ligjit "Për shoqëritë private".

Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

